



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2024:049877

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05515895

**PPP.nr.7/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG**, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Xh.A nga fshati G., Komuna I., përfaqësuar nga Jakup Çeku, avokat nga Peja, kundër debitorit H.K, nga fshati G., Komuna e I., përfaqësuar nga Adem Nikçi, avokat nga Peja, lidhur me çështjen përmbarimore në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega Istog C.nr.40/18, të datës 13.01.2021, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 27.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HEDHET POSHTË** i paafatshëm prapësimi i debitorit H.K, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.07/24 të datës 05.01.2024, i lëshuar nga Zyra Përmbarimore me përmbaruesin privat – Gjakë Radi në Gjakovë, ndërsa, Urdhri Përmbarimor P.nr.07/24 i datës 05.01.2024, mbetet në fuqi.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit H.K, ka caktuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.07/24 të datës 05.01.2024, duke e lejuar kështu në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega Istog C.nr.40/18, të datës 13.01.2021, i formës së prerë nga data 16.10.2023, i ekzekutueshëm nga data 03.11.2023, që debitori t'ia paguajë kreditorit shumën prej 6,460.00 €, në emër të kompensimit të dëmit, duke përfshirë edhe kamatën ligjore prej 8 % nga data 13.01.2021 e deri në datën e paraqitjes së urdhrin për përmbarim, si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, debitori ka ushtruar prapësim duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj urdhrin për përmbarim.

Kreditori brenda afatit ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit, me të cilën gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, urdhrit përmbarimor, prapësimin të paraqitur nga debitori si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për afatshmërinë e prapësimin konstatoi se prapësimi në fjalë është paraqitur jashtë afatit ligjor të paraparë në nenin 70, të LPP-së, në të cilin përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues”*. Nga shkresat e lëndës, gjegjësisht sipas fletë kthesës për dorëzim personal mbi dorëzimin e urdhrit për përmbarim, vërtetohet se debitori urdhrin për përmbarim e ka pranuar me datën 18.01.2024, ndërsa, prapësimin e ka dorëzuar përmes postës me rekomandë me datën 26.01.2024 e që në zyrën e përmbaruesit privat ka arritur me datën 30.01.2024, që nënkuptohet se nga pranimi i urdhrit përmbarimor e deri më ditën e paraqitjes së prapësimin në postë me datën 26.01.2024 kanë kaluar 8 ditë.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 70 dhe 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile  
PPP.nr.7/24, datë 27.03.2024

**Gj y q t a r j a**

Pajtesë Boshnjaku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.